

Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Nxënësit e klasave 8-12 do të marrin pjesë në Provimet Keystone midis 13 Majit dhe 24 Majit 2024.

Drejtorja Arsimore e Filadelfias udhëhiqet nga [Qëllimet dhe Objektat](#) e Bordit të Edukimit. Synimet e Bordit janë të shohë çdo student të performojë në nivelin ose mbi nivelin e klasës në Algjebër, Biologji dhe Letërsi, dhe të diplomohet gati për kolegji dhe karrierë. Provimet Keystone janë **kërkesa për diplomim nga shkolla e mesme** në Pensilvani dhe janë të rëndësishme për të kuptuar përparimin akademik të fëmijës suaj. Rezultatet gjithashtu u japin mësuesve informacion të vlefshëm për të mbështetur të mësuarit e secilit student dhe ato i lejojnë Drejtorisë të vazhdojë të përmirësojë kurrikulën dhe udhëzimet.

Provimet Keystone në Algjebër, Biologji dhe Letërsi janë të mandatuara nga shteti. Nxënësit zakonisht e marrin vlerësimin(et) në pranverë, teksa janë afër përfundimit të kursit(eve) Algjebra 1, Anglisht 2 dhe/ose Biologji. Çdo shkollë duhet të ketë pjesëmarrje 95% të nxënësve që marrin vlerësimet. Nëse shkollat bien nën 95% të pjesëmarrjes, rezultati i performancës shtetërore për shkollën ndikohet negativisht.

Gjatë periudhës së vlerësimit Keystone, është shumë e rëndësishme që nxënësit të ndjekin shkollën çdo ditë dhe të mbeten të regjistruar në shkollën e tyre aktuale. Për këtë arsye, kërkesat për transferime administrative do të shtyhen deri në fund të periudhës së vlerësimit, me përjashtime shumë të kufizuara.

Mund të mësoni më shumë rreth Provimeve Keystone duke përdorur lidhjet e mëposhtme. Shkolla e fëmijës suaj do t'ju dërgojë gjithashtu këtë informacion dhe mund ta gjeni në faqen tonë: [Keystone website](#).

- [Udhëzuesi i prindërve për Keystone](#): Një përmbledhje e Keystone me lidhje me burimet për familjet e drejtorisë
- [Pyetjet e bëra më shpesh](#): Një fletë faktesh nga Departamenti i Arsimit të Pensilvanisë (PDE) që ofron përgjigje për pyetjet e bëra shpesh
- [Karakteristikat dhe Akomodimet e Provimit Keystone](#): Një shpjegim i veçorive dhe akomodimeve të provimit, duke përfshirë një lidhje me Udhëzimet e plota të Akomodimit
- [Kodi i Sjelljes për Testuesit](#): Çfarë Të bësh dhe të mos bësh për studentët gjatë provimit

- **Pajisjet Elektronike Letra e Prindit**: Një letër për familjet që detajon rregulloren e PDE dhe pasojat për përdorimin e telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera elektronike gjatë provimit

Nëse keni pyetje në lidhje me vlerësimet e drejtorisë , ju lutemi kontaktoni “ Office of Evaluation Research, and Accountability”, [nëpërmjet formës së tyre të internetit](#). Nëse keni pyetje në lidhje me kërkesat e Drejtorisë për diplomim, ju lutemi kontaktoni “ Office of College and Career Readiness “ duke dërguar email në:gradreq@philasd.org ose duke vizituar [faqen e tyre të internetit](#).

Faleminderit që punoni me Drejtorinë për të mbështetur rritjen dhe suksesin e fëmijëve të Filadelfias. Ndërsa Provimet Keystone janë vetëm një mënyrë për të matur progresin, ato ofrojnë informacion shumë të rëndësishëm që ne mund t'i përdorim për të përmirësuar më tej shërbimin tonë ndaj fëmijëve dhe familjeve, për të informuar zbatimin e planit tonë strategjik dhe për të na ndihmuar në ndjekjen e vizionit tonë për t'u përgatitur të gjithë nxënësit të imagjinojnë dhe realizojnë çdo të ardhme që dëshirojnë!

Në partneritet,



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias